REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.3226/15 Prot. Sarandë, më 05.05.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :30.04.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Zv/Kryetare e Bashkisë Manjola Cikuli dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Përparim Ahmeti
6. Bejdo Çela
7. Elona Mano
8. Ermir Hoxha
9. Ibrahim Bajrami
10. Ilirjan Gërdhuqi
11. Lindita Kondi
12. Dritan Peçi
13. Laureta Çeçi
14. Denisa Islamaj
15. Farie Hyska
16. Kevin Alikaj
17. Vesel Koçiu
18. Ilva Qëndro
19. Angjele Lapa

20. Thanas Gurma
21. Eugen Qëndro
22. Anjeza Dike
23. Dafina Allkushi
24. Katerina Beqo

Mungojnë :

25. Klejdjan Murtaj
26. Shpëtim Ahmeti
27. Pranvera Osmani
28. Enea Vasili
29. Indi Rrapaj
30. Xhino Jaçaj

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 30.04.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin mars 2026".
2. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2026".
3. **P/vendim**"Për përjashtimin nga detyrimi mujor financiar të ushqimit në çerdhe dhe kopësht për D.RR ".
4. **P/vendim**"Mbi miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Sarandë për vitin 2025 ".
5. **P/vendim**"Për miratimin e nivelit të të ardhurave dhe të tavaneve të shpenzimeve të programit buxhetor vendor afatmesëm 2027-2029 ".
6. **P/vendim** "Per një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë per vitin 2026".
7. **P/vendim**"Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.121 datë 31.08.2023 "ngritjen e këshillit artistiko-kulturor dhe miratimin e rregullores së funksionimit dhe financimit të projekteve pranë Bashkisë Sarandë"
8. **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".
9. Informacion mbi ecurinë e investimeve publike në infrastrukturën rrugore,të financuara nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga fondet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Gjergji Imeraj : Unë propozoj që pika tetë të tërhiqet për arsye se ne kemi dijeni që këto projektvendime nuk kanë ardhur në kohë dhe nuk ka kaluar nëpër komisione.

Vesel Koçiu: Në mbledhjen e shkuar të kryesisë së këshillit kam kërkuar informacion në lidhje me inventarin e hapësirave publike të bashkisë dhe nuk kemi ndonjë përgjigje ose nuk është futur në rendin e ditës, dua të di cila është arsyeja që nuk është përfshirë në rendin e ditës kjo pikë. Ka ndonjë përgjigje për në lidhje me kërkesën që kam bërë si këshilltar?

Asaf Stroka: faleminderit, zoti Koçi. Atëherë, siç keni qenë edhe prezent në mbledhjen e kryesisë së këshillit, nuk ka ardhur asnjë material lidhur me materialet, por drejtori i urbanistikës mund të na japë një informacion nga ekzekutivi, sekretaria e këshillit të merret me korrespondencë lidhur me bashkinë Sarandë për sa i përket materialit që duhet të vinte në mbledhjen e këshillit.

Ibrahim Bajrami : Radhën e kaluar kam kërkuar dhe një raport nga urbanistika për sheshet të cilat janë miratuar, kontratat që bashkia ka bërë gjatë dy viteve të fundit. Është një informacion të cilin nuk e kemi. Na u premtua muajin e kaluar që do ta kishim kësaj radhe, përsëri nuk e kemi.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga z.Imeraj.

Miratohet me 24 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin mars 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përjashtimin nga detyrimi mujor financiar të ushqimit në çerdhe dhe kopësht për D.RR ".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 24 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Sarandë për vitin 2025 ".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Ilirjan Gërdhuqi: Në fillim, dua të ndalem shkurtimisht te çështja e komisionit. Pavarësisht se komisioni nuk arriti të realizojë kuorumin dhe nuk doli me një vendimmarrje formale, ai u zhvillua dhe diskutimet u mbajtën.

Sa i përket buxhetit faktik, do të nis nga relacioni dhe thelbi i tij, që lidhet me përmirësimin e llogaridhënies, transparencës dhe besimit të komunitetit. Në realitet, llogaridhënia është në nivelet më të ulëta që ka njohur ndonjëherë, ndërkohë që edhe transparenca lë shumë për të dëshiruar. Sa i përket besimit të komunitetit, kjo mbetet për t'u vlerësuar nga vetë qytetarët. Megjithatë, transparenca mungon jo vetëm për publikun, por edhe për ne si këshilltarë. Nuk dua të ndalem gjatë në këtë pjesë retorike, por të hyj më konkretisht në disa çështje.
Buxheti faktik i Bashkisë Sarandë për vitin 2025, në pjesën e shpenzimeve kapitale që lidhen drejtpërdrejt me investimet për qytetarët, si infrastruktura mbetet në të njëjtat nivele si vitet e mëparshme. Konkretisht, është rreth 27%, ndërkohë që në vitin 2024 ishte rreth 24–25%. Ky nivel është shumë i ulët në raport me nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve, dhe përbën një problem serioz.
Një tjetër çështje ku dua të ndalem është ajo e të ardhurave nga shitja e trojeve. Këtu lidhet edhe shqetësimi i ngritur nga kolegu Barjami. Nëse i referohemi shifrave, në vitet 2023 dhe 2024 të ardhurat nga shitja e trojeve kanë qenë rreth 320 milionë lekë të vjetra. Ndërkohë, për vitin 2025 ato janë vetëm 35 milionë lekë të vjetra. Kjo diferencë shumë e madhe tregon qartë se strukturat përgjegjëse nuk kanë funksionuar siç duhet. Nga këto të dhëna del në pah një rënie e ndjeshme në lidhjen e kontratave dhe realizimin e tyre. Do të ishte e nevojshme prania e drejtorit të urbanistikës për të dhënë shpjegime konkrete mbi arsyet e kësaj performance të dobët: pse nuk janë lidhur kontratat, pse nuk janë realizuar pagesat përkatëse dhe pse nuk janë gjeneruar të ardhura për buxhetin e bashkisë.
Gjithashtu, një tjetër pikë problematike janë të ardhurat e papërdorura. Duke marrë si referencë përvojën time si këshilltar në periudhën 2015–2019, atëherë kjo shumë ka nisur nga rreth 1 miliard lekë të vjetra. Ndërsa në vitin 2023 kemi pasur rreth 4 miliardë lekë të vjetra të papërdorura, dhe sot kjo shifër ka arritur në rreth 8 miliardë lekë, ose rreth 8 milionë euro. Në një masë të caktuar, është e pranueshme që të ketë fonde të papërdorura, por këto nivele tregojnë qartë mungesë koordinimi dhe organizimi nga ana e administratës së bashkisë. Projektet nuk po

përfundohen në kohë, çka sjell akumulimin dhe transferimin e vazhdueshëm të këtyre fondeve nga një vit në tjetrin.
Në vlerësimin tim, kjo përbën një dështim të administratës në menaxhimin efikas të burimeve dhe realizimin e projekteve.
Përse mbeten kaq të ardhura nga viti i kaluar ?
Përse investimet janë në vlerën 27%?
Teuta Stroka : Këto dy pyetje lidhen me njëra-tjetrën. Pse nuk janë realizuar investimet dhe si lidhet kjo me të ardhurat?

Ju përmendni vetëm realizimin në nivelin 7%, por nuk përmendni asnjëherë se sa janë rritur investimet nga të ardhurat e bashkisë. Sot, pothuajse të gjitha projektet që bashkia po realizon financohen nga të ardhurat e veta. Nuk kemi më financime nga buxheti i shtetit që kalojnë përmes bashkisë; ato financohen drejtpërdrejt nga instrumente të tjera. Prandaj është e drejtë të përmendet edhe ky fakt.
Sa i përket mosrealizimit të investimeve, duhet pasur parasysh se procedurat për miratimin dhe financimin e projekteve janë afatmesme dhe kërkojnë kohë. Kjo sjell zgjatje të periudhës së realizimit. Shumica e projekteve janë në proces, por ende jo të financuara.
Nuk ka fonde të shpërdoruara. Përkundrazi, janë fonde të mbajtura dhe të orientuara drejt investimeve. Aktualisht kemi rreth 1 milion euro investime që më parë nuk kanë qenë në këto nivele në buxhetin e bashkisë.
Për sa i përket transparencës dhe menaxhimit, bashkia ka vepruar në mënyrë korrekte. Informacionet mbi buxhetin, realizimin dhe të dhënat përkatëse janë të publikuara në faqen zyrtare. Edhe menaxhimi i fondeve është bërë me kujdes.

Dafina Allkushi : Në lidhje me buxhetin faktik të bashkisë dhe konkretisht me tabelën e investimeve publike, dua të ndalem te një çështje që është lehtësisht e verifikueshme nga çdo qytetar, pasi lidhet drejtpërdrejt me realitetin në terren.

Te pika 8 e tabelës së investimeve publike thuhet se është realizuar rikualifikimi i rrugëve të brendshme me beton në Njësinë Administrative Gjashte, për një vlerë të caktuar. Kjo është një çështje për të cilën kam pyetur edhe më parë dhe do të vazhdoj ta ngre derisa të marr një përgjigje të qartë.
Gjithashtu, te pika 15 përmendet rikualifikimi i rrugëve të brendshme dhe shtresave rrugore në Metoq, Berdenesh, Manastir dhe në Njësinë Gjashte.
Pyetja ime është shumë konkrete: të gjitha rrugët kanë emër dhe janë të identifikueshme. Prandaj kërkoj që të na bëhet me dije saktësisht:
Në cilat rrugë konkrete është realizuar rikualifikimi i rrugëve?
Në cilat sheshe janë kryer këto ndërhyrje?
Sot, realiteti në terren në zonën e Gjashte është krejt tjetër. Situata është problematike për shkak të ndërhyrjeve të një firme që punon me ujësjellësin, e cila ka hapur kanale përgjatë rrugëve dhe nuk i ka rikthyer ato në gjendjen e mëparshme.
Para fillimit të vitit shkollor në shtator, pas reagimeve të banorëve, është bërë vetëm një mbushje e pjesshme me dhe dhe në disa segmente me beton, por kjo nuk përbën rikualifikim. Aktualisht, qarkullimi në këto rrugë është i vështirë dhe gjendja mbetet pothuajse e njëjtë si më parë.
Në këtë kontekst, lind një mospërputhje e qartë midis asaj që raportohet në tabelën e investimeve dhe asaj që përjetohet në terren nga qytetarët.

Për këtë arsye, kërkoj transparencë të plotë dhe informacion të detajuar mbi vendndodhjet konkrete të këtyre investimeve.

Martjon Zhupa : Investimi vitin e kaluar është bërë dhe firma pret të vazhdojë punën pasi të kolaudohet ujësjellësi i zonës. S'mund të vazhdojnë të bëjnë ne një investim pa mbyllur një projekt të caktuar.

Vesel Kociu : Pyetja ime është për pikën shtatë te tabela: mbjellje pemësh dhe lulesh dekorative në rrugët publike të Sarandës. Për çfarë pemësh dhe bimësh dekorative bëhet fjalë dhe në cilat rrugë janë realizuar këto?

2.Thotë sistemim trotuaresh në rrugët e brendshme të Ksamilit. Për cilat rrugë bëhet fjalë, kur është bërë investimi gjatë vitit 2025?

Ibrahim Bajrami : Duket qartazi që ka ardhur koha të mos vazhdojmë më me praktika "copy-paste" si më parë. Ka nevojë për më shumë informacion dhe transparencë. Ne jemi të gjithë këshilltarë, nuk bëhet fjalë për pozitë apo opozitë. Të gjithë kemi përgjegjësi ligjore dhe duhet të jemi të informuar siç duhet.Nga diskutimet e bëra në këshill, është e qartë që të gjithë kemi nevojë për më shumë informacion. Ne transferojmë fonde nga një vit në tjetrin. Nuk po them që kjo nuk duhet bërë, është e nevojshme, sidomos për projekte në vazhdim, por dokumentacioni që na paraqitet duhet të jetë më i detajuar dhe i qartë.Duhet të kemi:listim të projekteve (projekti 1, 2, 3),përqindjen e realizimit për secilin,sa është paguar deri tani,sa mbetet për t'u paguar,dhe çfarë pritet të realizohet më tej.Nuk mund të konsiderohet një projekt i realizuar nëse është përfunduar vetëm pjesërisht.Shembull konkret është rruga "Adem Sheme", ku vazhdojnë problematikat dhe ka ende nevojë për ndërhyrje. Këto çështje duhet të shoqërohen gjithmonë me dokumentacion të plotë.Nga ana tjetër, kemi realizim vetëm 27% të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga kalimi i të drejtës së pronësisë. Kjo lidhet drejtpërdrejt me punën e bashkisë. Nëse nuk ka aktivitet këtë vit, do të kemi mungesa edhe vitin tjetër.Taksa e ndikimit në infrastrukturë sot varet nga lejet e ndërtimit që jepen nga qeveria qendrore. Kjo është një kompetencë që na është hequr dhe, sipas meje, në mënyrë të padrejtë. Njësoj si shumë kompetenca të tjera, përfshirë administrimin e arsimit, që sipas konventave ndërkombëtare duhet të ishte në nivel vendor.Sot, për shembull, kopshtet në Sarandë nuk mund të vendosin një mësues shoqërues pa koordinim me drejtorinë arsimore, gjë që shpesh krijon pengesa dhe probleme të vazhdueshme.Në kuadër të diskutimit për reformën territoriale, që do zhvillohet në Vlorë më 5 maj, duhet të theksojmë që bashkitë duhet të kenë më shumë kompetenca për administrimin e territorit të tyre.Si është e mundur që ne nuk japim dot leje ndërtimi në qytetin tonë? Informohemi më vonë që janë dhënë leje për ndërtime të mëdha dhe nuk kemi asnjë dijeni paraprake. Jam i bindur që ky këshill nuk do të kishte miratuar vendime të tilla pa diskutim.Po ashtu, na është hequr e drejta për administrimin e plazheve, që është një tjetër vendim i marrë pa transparencë dhe pa dëgjesë publike. Sot, plazhet jepen me qira pa përfshirjen e bashkisë.Edhe në raste të tjera, si administrimi i ujësjellësit, ky këshill ka hequr dorë nga kompetencat e veta.Këto janë çështje që duhen diskutuar seriozisht, sepse çdo ditë po humbasim më shumë të drejta.Në fund të fundit, për çfarë mblidhemi si këshill nëse nuk kemi të drejtë të vendosim për zhvillimin e qytetit tonë?Ka raste kur investimet bëhen pa u marrë parasysh mendimi i bashkisë

apo i komunitetit. Edhe në projekte konkrete, si fusha sportive, janë bërë ndërhyrje që nuk përputhen me kërkesat e komunitetit dhe të vetë bashkisë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 4.

Largohet këshilltari Ibrahim Bajrami ora 13:20.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e nivelit të të ardhurave dhe të tavaneve të shpenzimeve të programit buxhetor vendor afatmesëm 2027-2029".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 23 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Per një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë per vitin 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Ilir Gërdhuqi : Në lidhje me këtë projektvendim, ku janë projektet? A ka projekte të hartuara? Unë e kam kërkuar disa herë: ku kanë mbetur projektet?Çfarë segmenti po diskutojmë konkretisht? Jepini projektet në mënyrë që të kemi të qartë segmentin. Këtë e kam kërkuar vazhdimisht.Megjithatë, një pjesë e kësaj vlere që kërkohet, një pjesë e vogël shkon për paga dhe sigurime, gjë që është krejtësisht normale, pasi është miratuar sipas VKM-së për rritjen e pagave të punonjësve të administratës.Rreth 4 miliardë lekë, le të themi, parashikohen të shkojnë për financimin e projekteve. Po ashtu, në këtë kuadër kemi një parashikim për ndërtimin e një godine, siç e kemi diskutuar më parë, me katër kate dhe parkim në pjesën e pasme.Ajo që dua të theksoj është: a është e mundur të kemi projektin përpara se të miratojmë këto fonde?

Gjergji Imeraj: Shuma e trashëguar është në vlerën 425.377 mijë lekë. Pra, kjo është pyetja që ngrihet.A mund t'ia shpjegoni edhe Këshillit Bashkiak, edhe publikut, se çfarë përfaqëson kjo shumë që transferohet apo që kalon më pas në zëra konkretë?
Nga vjen kjo shumë, si është krijuar dhe mbi çfarë baze kalon në përdorim në buxhet?

Teuta Stroka: Duke qenë se kjo çështje është ngritur edhe më herët, do ta sqaroj edhe një herë, pasi është shpjeguar disa herë më parë.
Parashikimi i buxhetit, siç e dini, fillon me dëgjesat publike në muajt shtator, tetor dhe nëntor dhe duhet të përfundojë brenda afateve ligjore. Në këtë fazë nuk mund të përcaktohet me saktësi absolute niveli i të ardhurave, sepse buxheti nuk është një shifër fikse e garantuar.

Ne nuk mund të bëjmë një parashikim të saktë të të ardhurave, pasi nuk dimë me siguri se sa do të jenë të ardhurat në dy muajt e fundit të vitit, të cilët janë edhe vendimtarë. Mund të jenë më të larta ose më të ulëta se pritshmëritë.
Për këtë arsye, në fund të vitit mund të krijohen teprica fondesh. Këto teprica quhen 'trashëgim pa destinacion', sepse janë fonde që mbeten të papërdorura brenda vitit buxhetor për shkak të diferencës mes parashikimit dhe realizimit.
Këto nuk janë fonde të paidentifikuara, por janë të ardhura të realizuara të Bashkisë gjatë vitit 2025, të cilat mbarten dhe futen në buxhetin e vitit 2026.
Si çdo vit tjetër, edhe këtë vit, rreth 90% e këtyre fondeve janë përdorur për financimin e investimeve në infrastrukturë. Këto projekte kanë vlera të konsiderueshme dhe në disa raste fondet nuk janë të mjaftueshme, ndaj financimet e tyre shtrihen edhe në vitet 2027 dhe ndoshta edhe 2028, pasi janë projekte të shumta në numër dhe me kosto të lartë.

Vesel Koçiu: Jam dakord me shpjegimin që bëri drejtoresha, pasi është e qartë që fondet e mbartura nga viti i kaluar do të kalojnë dhe do të planifikohen në destinacionet përkatëse.
Megjithatë, problemi që përsëritet vazhdimisht është se në Këshill na vijnë vetëm tabela me investime, pa qenë të shoqëruara të paktën me një projekt-ide.
Duhet të krijohet një praktikë ku para këshilltarëve të paraqitet projekt-idea, dhe jo vetëm tabela për miratim. Ne duhet të miratojmë projektin dhe idenë e bashkisë, jo vetëm një listë shifrash.
Për më tepër, investimet që përzgjedh bashkia nuk shoqërohen me dëgjesa publike reale, ku të përcaktohet se cilat rrugë apo zona kanë prioritet në njësitë vendore apo në lagje të caktuara, në bashkëbisedim me banorët.
Në vend të kësaj, prioritetet përcaktohen nga vetë bashkia, projektet hartohen nga vetë ajo, dhe mungon kontrolli dhe konsultimi real, ndërsa ne na vijnë vetëm tabela për t'i miratuar.
Kjo praktikë duhet të ndryshojë, prandaj në këtë projektvendim vota ime është kundër.

Përparim Ahmeti: Duke parë tabelën e investimeve në këtë shtesë buxheti, më vjen mirë që Ksamilit i është dhënë përparësi dhe janë parashikuar financime për rrugët e brendshme, trotuaret dhe pedonalet.Më vjen veçanërisht mirë që më në fund po trajtohet edhe një nga kërkesat më të përsëritura të qytetarëve: nevoja për parkime. Më në fund kemi një projekt nga Bashkia për ndërtimin e një parkimi të shumëpritur dhe të kërkuar prej kohësh në Këshill.Edhe pse kapaciteti prej rreth 190 vendesh parkimi nuk i plotëson plotësisht nevojat reale, gjithsesi është një hap pozitiv dhe një angazhim i rëndësishëm për zgjidhjen e këtij problemi. Vendndodhja, për mendimin tim, është e përshtatshme dhe e përshëndes këtë investim, si dhe ata që kanë kontribuar për sjelljen e tij.Megjithatë, shqetësimi kryesor lidhet me gjendjen aktuale të punimeve në Ksamil. Aktualisht punojnë disa firma, dhe mënyra e organizimit dhe menaxhimit të punimeve lë për të dëshiruar. Sidomos situata në zonën e Ksamilit paraqitet e rënduar dhe e paorganizuar, çka krijon një imazh negativ në prag të sezonit turistik.Kjo papërgjegjshmëri në menaxhimin e punimeve, në vend që të përmirësojë situatën,e përkeqëson atë, sidomos në një periudhë kaq të rëndësishme si sezoni turistik.Nga ana tjetër,vlerësoj firmat që punojnë me përkushtim, si ajo që po realizon trotuaret, duke punuar me orare të zgjatura dhe ritëm të qëndrueshëm, nga mëngjesi deri në mbrëmje.
Gjithashtu, problematikë mbetet gjendja e shëtitores dhe e bizneseve përgjatë saj, të cilat përfaqësojnë një potencial të madh ekonomik dhe turistik. Biznese të rëndësishme dhe taksapagues të mëdhenj ndodhen përballë një situate të papranueshme infrastrukturore.

Është e nevojshme që investitorët dhe subjektet përgjegjëse për këto punime të mbajnë përgjegjësi, pasi dëmi nuk i shkaktohet vetëm bizneseve, por gjithë turizmit të Ksamilit dhe imazhit të Sarandës në tërësi.Në përfundim, unë këtë projekt do ta votoj, pasi shoh që lidhet me investime të domosdoshme, veçanërisht parkimi, për të cilin është punuar dhe kërkuar prej kohësh. Ka ardhur momenti që ky projekt të miratohet.

Bejdo Çela: Duke parë listën shtesë të këtij projektvendimi, dhe duke iu referuar pikërisht këtij projekti, jam në dakordësi me mendimin e kolegëve të tjerë që çdo investim duhet të jetë i shoqëruar me projektin përkatës.Megjithatë, duke parë situatën ku ndodhemi dhe faktin që disa nga projektet janë tashmë në proces apo në gjendje zbatimi, sidomos rikualifikimi i rrugës me trotuare dhe ndriçim, mendoj se kjo është faza e dytë e një projekti ekzistues dhe duhet trajtuar si i tillë.Në këtë kuadër, nuk kemi pse ta penalizojmë këtë pjesë të investimeve, duke marrë parasysh edhe rëndësinë e ndërhyrjeve në zonën e hyrjes, pranë shkollës dhe në qendër të qytetit, të cilat kanë nevojë për përfundim sa më të shpejtë.Për këtë arsye, mendoj se ose duhet ta shkëpusim këtë pjesë dhe ta trajtojmë veçmas, ose ta miratojmë projektvendimin siç është, duke mos vonuar më tej procedurat, pasi bëhet fjalë për ndërhyrje emergjente.E njëjta gjë vlen edhe për rrugët e tjera, ku ndërhyrjet janë të domosdoshme dhe nuk mund të shtyhen pafundësisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë në këtë fazë.Po ashtu, edhe në rastin e parkimeve, ku ne kemi kërkuar vazhdimisht zgjidhje, çdo vonesë e mëtejshme do të ndikonte negativisht në situatën aktuale.E njëjta gjë vlen edhe për mobilimin e kopshteve dhe shkollave. Nëse ne do të mbetemi peng i burokracive dhe do të kërkojmë gjithmonë që gjithçka të jetë e plotë në çdo detaj, atëherë rrezikojmë të mos kalojmë asgjë.Prandaj, unë mendoj se këto duhet të ndahen sipas urgjencës dhe të miratohen ato që janë më emergjente, ose në të kundërt të shtyhet projektvendimi për një mbledhje tjetër, ku të vijnë të plotësuara të gjitha materialet dhe të trajtohen në mënyrë të unifikuar.Në çdo rast, duhet të ketë edhe një përgjegjësi për mosparaqitjen e plotë të dokumentacionit, sepse në çdo mbledhje ngrihen të njëjtat shqetësime dhe nuk mban askush përgjegjësi për këtë përsëritje të vazhdueshme të mungesave."

Angjele Lapa: Dua të them se ky material që na është sjellë ngjan si një dokument i paplotë informimi, ku mungon thelbi i sqarimeve që ne kemi nevojë të marrim.
Ne kemi nevojë për më shumë informacion. Të gjithë këtu po kërkojmë të njëjtën gjë: informacion, informacion, informacion.Lexoj disa pika në këtë material, si për shembull rikualifikimi i shkallëve në Sarandë. Saranda ka shumë shkallë, dhe nuk është normale që ne të vijmë këtu dhe të kalojmë orë të tëra duke pyetur se për cilat shkallë konkretisht bëhet fjalë.
Unë jam pro këtij projektvendimi. Le të miratohen fondet, le të ecet përpara. Në fund të ditës, këto janë investime që i shërbejnë qytetit dhe unë, si qytetar i këtij vendi, e mbështes këtë.
Por ajo që mungon është informacioni konkret: cilat ndërhyrje do të bëhen, ku do të bëhen dhe si do të përfundojnë. Çdo qytetar mund të preket drejtpërdrejt nga këto investime dhe ka të drejtë të dijë dhe të ngrejë pyetje apo shqetësime në bashki.Në këtë kuptim, informacioni që na jepet është shumë i vakët. A ka hapësirë për përmirësim? Besoj se po, dhe kjo është shumë e lehtë për t'u rregulluar.Shpresoj që nuk do të kemi të njëjtin problem edhe në vitin e tretë të punës sonë në Këshill, ku vazhdojmë të kërkojmë vetëm informacion bazë.Meritojmë më shumë transparencë dhe më shumë sqarime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 1, kundër 5.

Largohet këshilltari Angjele Lapa ora 13:45
Largohët këshilltarja Ilva Qëndro ora 13:48

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.121 datë 31.08.2023 "ngritjen e këshillit artistiko-kulturor dhe miratimin e rregullores së funksionimit dhe financimit të projekteve pranë Bashkisë Sarandë"

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.
Miratohet me 21 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

Informacion mbi ecurinë e investimeve publike në infrastrukturën rrugore,të financuara nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga fondet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Gjatë diskutimit për këtë pikë të rendit të ditës, këshilltarët ngritën shqetësime të shumta lidhur me cilësinë dhe zbatimin e punimeve publike që po realizohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në zonat e Ksamilit dhe Sarandës, veçanërisht në zonat turistike dhe përgjatë shëtitoreve.
U theksuan problematika të lidhura me:

- cilësinë e dobët të punimeve dhe mungesën e standardeve në realizim.
- dëmtimin e peizazhit natyror, përfshirë mbushjen e plazheve me dhera dhe ndryshime në vijën bregdetare.
- degradimin e shpejtë të rrugëve dhe trotuareve pas ndërhyrjeve.
- mungesën e kontrollit dhe monitorimit efektiv gjatë zbatimit të projekteve.
- mungesë planifikimi teknik dhe koordinimi me infrastrukturën ekzistuese.
- probleme me azhornimin dhe sistemet e kanalizimeve.
- prerje pemësh dhe ndikim negativ në mjedis.
- standarde të dobëta në organizimin e parkimeve dhe elementëve të sigurisë rrugore.
- Gjithashtu u ngritën shqetësime për mospërputhje mes projekteve të miratuara dhe situatës reale në terren, sidomos në matje dhe zbatim teknik.
- Në diskutim u evidentua edhe nevoja për përmirësimin e aksesueshmërisë publike, duke kërkuar rishikimin e bordurave dhe elementëve urbanë për të garantuar lëvizje më të lehtë për karrocat e fëmijëve dhe personat me aftësi të kufizuara.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e bashkisë argumentuan se disa ndërhyrje, si ndryshimet në parkim dhe organizimin e qarkullimit, janë bërë për arsye të menaxhimit të trafikut dhe funksionalitetit urban. Ata deklaruan se një pjesë e problematikave do të rishikohen në fazat e ardhshme të zbatimit.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 11(njëmbëdhjetë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj